



Një person i vrarë dhe një e plagosur me armë zjarri në Prishtinë

LAJME

LAJMI I FUNDIT

Më afër lexuesit.

26/03/2024 23:13

f

🐦

🔗

Një person është vrarë dhe një është plagosur si pasojë e gjuajtjes me armë zjarri sot në Prishtinë.

Zëdhënësi i policisë për rajonin e Prishtinës, Agron Borovci, tha se po punohet me qëllim identifikimin e të dyshuarve të implikuar në rast, si dhe sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes.

“Rreth orës 21:15, është raportuar për gjuajtje me armë zjarri të ndodhur në rrugën “Jeronim De Rada” në Prishtinë. Me të marrë informatën, policia ka dalë në vendin e ngjarjes dhe nga informacionet e para është bërë e ditur se për pasojë dy persona kanë marrë plagë nga arma e zjarrit ku fatkeqësisht njëri nga ta ka ndërruar jetë. Ndërkohë që e plagosura është dërguar në QKUK për trajtimin e nevojshëm mjekësor, policia po vijon punën e saj me veprime të ekзамinimit të vendngjarjes si dhe me veprime të tjera operativo-hetimore me qëllim identifikimin e të dyshuarve të implikuar në rast, si dhe sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes”, ka thënë Borovci.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LaptopMedia



Artikuj të ngjashëm



March 27, 2024
Ganimete Musliu kthehet në Kosovë: Falë Zotit jam mirë



March 27, 2024
Pasi u votua në Paris, Asambleja Parlamentare e KE-së tregon datën...



March 27, 2024
Kurti për familjen Querkezi: Dëshmon gjenocidin dhe spastrimin etnik të Serbisë...



March 27, 2024
Osmani kujton masakrën në lagjen “Dardania” në Pejë: Synim i regjimit...



March 27, 2024
Sukses i madh: Kosova kalon votimin, rekomandohet anëtarësimi në Këshillin e...



March 27, 2024
Konjufca bëri homazhe në lagjen “Dardania” në Pejë: Sakrifica ndër vite...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information